



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.2535/2026

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Udhëzimi Administrativ Nr.03/2014 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë neni 16 pika 3, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit neni 57, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2026 merr:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
PËR VITIN 2025

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025.
2. Duke ju referuar nenit (1) të këtij vendimi pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i punës për vitin 2025 i Komitetit për Komunitete.
3. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e Komitetit për Komunitete,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 31.03.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.3024/2026

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 12, paragrafi 2, shkronja (d), neni 24 dhe 40, Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal neni 2, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2026 merr:

VENDIM

Për rritjen e buxhetit për Ndërmarrjen Publike Lokale "Pastrimi" Sh.a

1. Me këtë vendim miratohet rritja e buxhetit për Ndërmarrjen Publike Lokale "Pastrimi" Sh.a në Komunën e Hanit të Elezit, me qëllim të përballimit të rritjes së kostove dhe zgjerimit të shërbimeve publike për qytetarët.
2. Buxheti i NPL "Pastrimi" Sh.a rritet për shumën prej: 25,000.00 € (njëzet pesë mijë euro) dhe mjetet financiare për realizimin e këtij vendimi do të sigurohen nga: bartja e bilancit të pashpenzuar të vitit 2025 në kuadër të kategorisë buxhetore Subvencione dhe Transfere.
3. Rritja e buxhetit bëhet për shkak të: rritjes së kostove operative (karburant, mirëmbajtje, paga), zgjerimit të shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave në zonat urbane dhe rurale, nevojës për rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve publike.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shërbime Publike, Menaxhmenti i NPL "Pastrimi" Sh.a.
5. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ndërmarrjen Publike Lokale "Pastrimi" Sh.a,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës

Hani i Elezit
Data: 31. 03. 2026

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

